



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:091683

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05756338

KF.nr.400/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit N.P.T “Rubicon” L.L.C., me nr. fiskal 600909694 dhe seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Shoqëri e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, baza juridike vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 10.05.2024 në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në prani të përfaqësueses të palës së paditur Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.P.T “Rubicon” L.L.C., me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/1881/2019 të datës 22.03.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.P.T “Rubicon” L.L.C, me seli në Prishtinë t’ia kthej shumën prej 2,500.87 Euro (dymijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R670/15.01.2019, R 661/15.01.2019, R 1311/15.01.2019, R1993/18.01.2019, R 1050/21.01.2019, dhe R1056/21.01.2019, të proceduara në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë dhe Prizren në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.P.T “Rubicon” L.L.C me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 14.05.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet si i pabazuar Aktvendimi i të paditurës dhe të obligohet e paditura që mjetet monetare të paguara në emër të detyrimeve doganore t’iu kthen ankuesit. Ka theksuar se Zyra Doganore në mënyrë të gabuar ka vlerësuar mallin doganor me metodën e 6 të vlerësimit të mallit dhe nuk e ka arsyetuar anashkalimin e metodave të tjera të vlerësimit, pasi që nuk mund të kalohet në metoda të tjera të vlerësimit të mallit pa kaluar nëpër metodat paraprake, po ashtu ka cekur se në mënyrë të gabuar ka konstatuar vlerën e mallit doganor duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit të mallit dhe në metodën e tretë dhe nuk ka saktësuar cili është ai mall doganor i ngjashëm apo identik të importuar në Kosovë, çfarë sasi e mallit me e madhe e importuar është marr për bazë, të gjitha këto gabime në aplikimin e kësaj dispozite e bëjnë të pavlefshëm rivlerësimin e këtij malli. Tutje ka shtuar se Zyra Doganore ka shkel dispozita procedurale, sepse nuk mund ti kontestohet çmimi i mallit pa u dëshmuar jovaliditeti i dokumentit të mallit, rritja e çmimit blerës së mallit është arbitrare edhe pa asnjë mbështetje në rregullat e tregut dhe janë dëmtuar financiarisht në mënyrë krejtësisht jo ligjore. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës paditëse ngase përfaqësuesi i palës paditëse për seancë e datës 10.05.2024 e ka pranuar ftesën me datë 22.04.2024, mirëpo mos prezencën nuk e ka deklaruar.

E paditura në përgjigje në padi të datës 15.04.2022 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin konstuese si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10.05.2024, ka deklaruar se kontestojnë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit, aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe përcaktimi i vlerës së mallrave është bazuar në metodën e tretë të vlerësimit, neni 34 par 2 pika b të KDA-së, respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit të mallrave të ngjashme të zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin

lëndor kontestues, pasi që malli i marr për bazë është mall i ngjashëm me karakteristika të njëjta, të shtet eksportuesit dhe të origjinës, kod tarifor të njëjte, përshkrim të ngjashëm por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit se vlera e deklaruar e paditësit. Po ashtu e paditura ka kërkuar nga paditësi që të sjellë dokumente shtesë që posedon për importet kontestuese, mirëpo i njëjti është përgjigjur se nuk e posedon deklaratën eksportuese të shtetit eksportues. Pra në procedurë të rivendosjes nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë të kërkuar nga e paditura po ashtu mungon edhe kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të importuesit dhe eksportuesit të mallit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se bazuar në thëniet e cekura si më lart, e paditura i propozon gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 10.05.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendim nr. 01.3.2.2/1881/2019 i datës 22.03.2021, Deklarata doganore, Pro faturat dhe faturat, Urdhër pagesat bankare, Marrëveshje transporti, Detajet e dërgesës, Aktvendim nr. 01.3.2.2/1881/2019 i datës 27.03.2019, Aktgjykim A.nr 1261/19 Ankesë e datës 29.05.2019, Procesverbal i datës 20.01.2021 dhe Proceset mbi përcaktimin e vlerave të mallrave.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur për Deklaratat Unike Doganore si në dispozitiv të këtij aktvendimi, gjatë përcaktimit të vlerës së mallrave është bazuar në metodën e tretë (3) të vlerësimit, neni 34 paragrafi 2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit të mallrave të ngjashëm të zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues, pasi që malli i marr për bazë është mall i ngjashëm me karakteristika të njëjta të shtetit eksportues dhe të origjinës, kod tarifor të njëjtë, përshkrim të ngjashëm, por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit se vlera e deklaruar e subjektit në procedurë. Lidhur me dokumentacion edhe pse i është dhënë mundësia për të prezantuar i njëjti nuk ka prezantuar në procedurë të rivendosjes së lëndës kontestuese, si dhe në shkresat e lëndës mungon kontrata e shitblerjes së lidhur në mes importuesit dhe

eksportuesit të mallit. Dogana e Kosovës konstaton se subjekti nuk ka arritur të dëshmoj që vlera e deklaruar është vlerë reale e mallit, gjithë duke pasur parasysh që Dogana e Kosovës disponon me të dhëna të zhdoganimeve të ngjashme lidhur me vlerën e mallit, andaj vlera e caktuar nga Dogana konsiderohet vlera reale e mallit lëndor kontestues.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë*”. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se “*a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*”.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit të transfereve bankare, pro faturave, faturave të bashkangjitura si dhe DUD-ve, e sipas të cilave gjykata konstaton se subjekti në procedurë ka bërë pagesën për mallin përkatësish 30 % të vlerës së pro faturës TR20181024S01 e cila ka një vlerë të përgjithshme prej 52,702.04 dollar amerikan, pagesa prej 30 % të vlerës së përgjithshme të pro faturës është 15,810.61 Euro. Sa i përket faturës së mallit me numër TR20181024S01 ka një vlerë më të lartë se pro fatura sipas të cilës është bërë pagesa bankare pasi në këtë faturë është përfshirë edhe një pjesë e mallit e porositur sipas pro faturës

TR20181031S01 e datës 31.10.2018. Sipas pagesës bankare të datës 31.10.2018 është bërë pagesa prej 70 % të pro faturës TR20181024S01 dhe parapagimi prej 30 % të pro faturës TR20181031S01 në vlerë prej 1, 717.5 Euro. Sipas pro faturës TR20181031S01, e cila është cekur dhe më lart se është paguar 30 % e saj dhe e cila ka një vlerë prej 7, 094.68 Euro, pasi disa emërtime në këtë pro faturë si 1, 5, 6, 7 dhe 8 janë hequr nga kjo faturë dhe janë shtuar në faturën TR20181024S01, e cila ka një vlerë prej 5,725 Euro dhe për këtë është paguar parapagimi prej 1,717.5 Euro. Në faturën TR20181024S01 është shtuar emërtimi 5 dhe 6 për emërtime të tjera ka pasur sasi më të madhe sesa është porositur sipas pro faturës. Ndërsa pjesa tjetër e pagesës për pro faturën TR20181031S01 përkatësisht 70 % e saj është bërë sipas pagesës bankare të datës 31.10.2018 në këtë pagesë është paguar edhe një pagesë për sigurim në vlerë prej 50 dollar.

Pas analizimit të faturave gjykata konstaton se çmimi në faturë është çmimi real i cili është paguar kjo vërtetohet edhe me transaksionet bankare e që rezulton që çmimi të jetë paguar sipas vlerës së deklaruar.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave, R 670/15.01.2019, R 661/15.01.2019, R1311/15.01.2019, R 1993/18.01.2019, R 1050/21.01.2019, dhe R 1056/21.01.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 2,500.87 Euro mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së tretë dhe të gjashtë të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, për arsye se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e gjatë e vlerësimit duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuar të paditurës lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 2,500.87 Euro të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes dudave kontestues të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.400/22, datë 10.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.